

Grenelli mbështet
pafajësinë e Thaçit,
Veselit, Krasniqit
dhe Selimit I FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBROJTJA E JAKUP KRASNIQIT NIS PARAQITJEN E DEKLARATËS PËRMBYLLËSE
NË RASTIN E LIDERËVE TË UÇK-SË

JAKUP KRASNIQI ËSHTË I PAFAJSHËM, ZPS-ja MBYLLI SYTË PARA FAKTEVE I FAQE 4-5

Mbrojtja e Jakup Krasniqit të premten ka filluar paraqitjen e deklaratave përmbyllëse në procesin gjyqësor në Hagë dhe do të vazhdojë edhe të hënën e javës së ardhshme. Sikurse mbrojtja e Thaçit, Veselit dhe Selimit, edhe ajo e Krasniqit ka çmontuar pretendimet e ZPS-së në raport me katërshen e UÇK-së. Avokatja Venkateswari Alagendra ka vlerësuar se trupi gjykues ka para vetes vetëm një opsion: "Jakup Krasniqi të shpallet i pafajshëm". Ajo e ka akuzuar ZPS-në se pretendimet e saj janë të mbështetura në spekulime. Po ashtu, ajo e ka akuzuar ZPS-në se ka mbyllur sytë para provave që nuk i përshkateshin asaj



PAS SHOQPËRISË,
EDHE KUVENDI
I KOSOVËS MIRATON
REZOLUTË NË
MBROJTJE TË
KRERËVE TË UÇK-së F. 8



HARADINAJ
JEP DORËHEQJE
NGA KRYETARI
I AAK-së, HAP
GARËN PËR
KUADROT
E REJA F. 3



RUBIO: BOTA NDODHET NË NJË
ÇAST PËRCAKTUES F. 2

VASFIJE KRASNIQI MBËSHTET
MARSHIN "DREJTËSI,
JO POLITIKË" F. 7

56-VJETORI I UP-së: NDEROHEN
PROFESORËT DHE PUNËTORËT
ADMINISTRATIVË QË PËRFUNDUAN
PUNËN F. 7

EKONOMI



FMN-JA VLERËSON
PERFORMANCËN EKONOMIKE
DHE STABILITETIN FINANCIAR
TË KOSOVËS F. 8

DEPUTETËT MIRATOJNË
ZGJATJEN BUXHETORE
PËR MUAJIN MARS F. 8

SPORT



KOSOVA NË GRUPIN B3 TË LIGËS
SË KOMBEVE F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



Kolegji
BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

RUBIO: BOTA NDODHET NË NJË ÇAST PËRCAKTUES

UASHINGTON, 13 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, ka mbërritur në Gjermani për të marrë pjesë në Konferencën e Sigurisë në Muni (MSC), duke thënë se bota ndodhet në një “moment përcaktues”. “Bota po ndryshon shumë shpejt para syve tanë. Bota e vjetër ka ikur - sinqerisht, bota në të cilën u rrita - dhe ne jetojmë në një epokë të re në gjeopolitikë, dhe kjo do të kërkojë nga të gjithë ne që të rishqyrtojmë se si duket kjo dhe cili do të jetë roli ynë”, tha Rubio në komentet para nisjes nga baza ajrore Andrews në Maryland. Rubio tha se ka gjasa të takohet me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky më 14 shkurt, kur ai të arrijë, megjithëse nuk ishte “100 për qind” i sigurt se takimi do të ndodhë.

I pyetur për sulmet e vazhdueshme ruse ndaj infrastrukturës energjetike të Ukrainës, të cilat kanë zhytur qindra mijëra njerëz në të ftohtë dhe errësirë gjatë dimrit, Rubio tha se kjo është arsyeja pse Uashingtoni po vazhdon përpjekjet për paqe. “Njerëzit po vuajnë. Është koha më e ftohtë e vitit. Është vuajtje e paimagjinueshme,” shtoi ai. Ministri i Jashtëm i Ukrainës, Andriy Sybiha, i tha Radios Evropa e Lirë se pret të flasë gjithashtu me Rubion. “Ne do të jemi të interesuar [të vazhdojmë] kontaktet tona të rregullta në nivelet më të larta”, tha Sybiha, i cili mirëpriti vizitorë, përfshirë ministrin e Jashtëm gjerman, Johann Wadepful, në një ekspozitë dronësh në “Shtëpinë e Ukrainës” në Muni. “Vetëm [presidenti



amerikan Donald] Trump mund ta përfundojë luftën, vetëm pala amerikane”, i tha Sybiha REL-it. Organizatorët e MSC-së thanë se ngjarja e këtij viti është më e madhja ndonjëherë, me më shumë se 1 000 delegatë, përfshirë rreth 50 krerë qeverish dhe diplomatë të lartë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjithashtu ka konfirmuar se është nisur për të marrë pjesë në konferencë më 13 shkurt, ndërkaq presidentja Vjosa Osmani ka anuluar pjesëmarrjen e saj “për shkak të “angazhimeve institucionale dhe prioriteteve që lidhen me zhvillime brenda vendit”. Konferenca e Muniut po zhvillohet në një kohë trazirash globale, me mundësinë e sulmeve ajrore të ShBA-së ndaj Iranit, me pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës

nga Rusia që po i afrohet përvjetorit të katërt dhe me tensione lidhur me të ardhmen e aleancës transatlantike të NATO-s. Këto shqetësime të fundit u shfaqën në një aktivitet të vogël anësor në prag të konferencës, ku ish-presidenti i Komisionit të BE-së, Jose Manuel Barroso, tha: “ne duhet... të mbetemi atlantikë, por ta evropianizojmë NATO-n.” Barroso bëri thirrje për pavarësi më të madhe evropiane në mbrojtje mes frikës se Uashingtoni po tërhiqej nga angazhimi, duke shtuar se zgjerimi i Bashkimit Evropian për ta përfshirë Ukrainën do ta forconte gjithashtu sigurinë e tij. “Të jemi të singertë, ata nuk do të jenë anëtarë të NATO-s”, i tha Barroso REL-it. “Por anëtarë të Bashkimit Evropian - mendoj se mund të jenë. Pra, le të

gjejmë një mënyrë”. E pyetur se çfarë pret nga fjalimi i Rubios në konferencë më 14 shkurt dhe nga angazhimi i ShBA-së me evropianët, ministrja e Jashtme e Rumanisë, Oana Toiu, u tha gazetarëve: “Shpresoj që delegacioni i ShBA-së... do të ritheksojë një mesazh të fortë mbështetjeje”. “Dhe gjithashtu përtej fjalëve, përtej bisedave, mendoj se ajo që na duhet tani është veprim i përbashkët, burime të përbashkëta për qëndrueshmërinë, por edhe për procesin e paqes [në Ukrainë].” Toiu shtoi se “ndërtimi ose rindërtimi i besimit në partneritetin transatlantik është gjithashtu shumë i rëndësishëm për hapat e ardhshëm në procesin e paqes në Ukrainë.” Kancelari gjerman Friedrich Merz do ta hapë zyrtarisht

konferencën menjëherë pas drekës, duke vendosur tonin për diskutimet pasuese. Në fjalimet e fundit ai ka dyfishuar theksin në mesazhin se Evropa duhet ta forcojë fuqinë e saj ushtarake përballë agresionit rus dhe pasigurisë mbi angazhimin e Uashingtonit ndaj NATO-s. Evropa do të dëgjohej vetëm “kur të mësojmë gjuhën e politikës së fuqisë, kur të bëhemi vetë një fuqi evropiane”, tha ai në janar. Gjendja mbizotëruese këtu pasqyrohet edhe në titujt e diskutimeve të ndryshme të planifikuara. Dita fillon me një mëngjes lutjeje të titulluar “Ndërtimi i Urave në një Botë të Tensionuar”, i ndjekur nga një panel diskutimi i quajtur “Rregulla pa Fuqi? Zhvillimi i Kapacitetit Gjeostrategjik të Evropës”. Diskutimi në skenën kryesore pasdite quhet “Pikë Thyerjeje: Rendi Ndërkombëtar mes Reformës dhe Shkatërrimit”. Gjatë rrugës për në Muni, Rubio shprehu besim se mesazhi i tij për evropianët e shqetësuar do të “pritej mirë”. Ai shoqërohet nga një grup i madh dypartiak senatorësh amerikanë, të cilët kanë njoftuar takime me Zelenskyyn, shefin e NATO-s Mark Rutte dhe të tjerë. Në një deklaratë, anëtarja kryesore e Komitetit për Marrëdhëniet me Jashtë të Senatit, Jeanne Shaheen, tha se do ta përdorë këtë udhëtim për ta “forcuar mbështetjen për Ukrainën dhe për t’u bërë thirrje kolegëve të saj në Kongres që të miratojnë legjislacion dypartiak për sanksione për ta mbajtur Rusinë dhe mbështetësit e saj përgjegjës”.

SINISHA KARAN ZGJIDHET PRESIDENT I REPUBLIKËS SËRPSKA

SARAJEVË, 13 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Bosnjë-Hercegovinës ka konfirmuar dhe publikuar rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme për president të entitetit të Republikës Sërpska, sipas të cilave, Sinisha Karan është zgjedhur në këtë post. Karan, kandidat i Aleancës së Socialdemokratëve të Pavarur (SNSD) të Millorad Dodikut, do ta ushtrojë këtë funksion deri në mbajtjen e zgjedhjeve të reja të përgjithshme, të cilat

pritet të zhvillohen në muajin tetor të këtij viti. Zgjedhjet e parakohshme të përsëritura për president të Republikës Sërpska janë mbajtur më 8 shkurt në 16 qytete të këtij entiteti dhe në Distriktin e Bërçkos. Në zgjedhje kanë votuar 41 826 qytetarë, apo 49.51 për qind. Të drejtë vote kanë pasur gjithsej 84 474 votues. Zgjedhjet janë mbajtur në 136 vendvotime në 17 njësi të vetëqeverisjes lokale në Republikën Sërpska dhe

Distriktin e Bërçkos. Ato janë përsëritur pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Bosnjë-Hercegovinës kishte zbuluar keqpërdorime gjatë votimit të mbajtur më 23 nëntor 2025. Zgjedhjet janë shpallur pas vendimit me të cilin, në gusht të vitit 2025, Millorad Dodikut i është hequr mandati i presidentit të Republikës Sërpska, për shkak të dënimit për mosrespektim të vendimeve të përfaqësuesit të lartë ndërkombëtar në Bosnjë.



PAS SHQIPËRISË, EDHE KUVENDI I KOSOVËS MIRATON REZOLUTË NË MBROJTJE TË KRERËVE TË UÇK-së

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 SHKURT - Me 90 vota për, një kundër dhe asnjë abstenim, është votuar një rezolutë e përgatitur nga një grup ekspertësh dhe e mbështetur nga Partia Demokratike e Kosovës, nëpërmjet së cilës kërkohet nga Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë që, në ushtrimin e funksioneve të tyre, të sigurojnë zbatimin me përpikëri të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës, që përmban standardet më të mira ndërkombëtare lidhur me një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm, duke respektuar gjithashtu parimet e transparencës, llogaridhënies dhe kultivimit të besimit të publikut në drejtësi.

Në prezantimin e përmbytjes së kësaj rezolute, deputeti Gruda potencoi se rezoluta është hartuar nga ekspertë të pavarur, duke shtuar se i takon Kuvendit të Kosovës të ketë një qëndrim lidhur me procesin gjyqësor që po zhvillohet në Hagë.

Përmes rezolutës u bëhet thirrje Dhomave dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuara që t'i zbatojnë standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të të akuzuarve, "përfshirë edhe detyrimet që burojnë nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

Ky dokument thotë që shtetet mbështetëse dhe financuese të Gjykatës Speciale marrin përgjegjësi për shkeljet që ndodhin në Gjykatën në Hagë. Aty, po ashtu, konfirmohet zotimi i Kosovës për mbështetjen financiare të të akuzuarve në mbështetje të mbrojtjes së tyre. Edhe Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar një deklaratë për pafajësinë e ish-eporëve të UÇK-së që po gjykohen në Hagë. Miratimi i rezolutës në Kosovë dhe deklaratës në Shqipëri vjen në kohën kur në Hagë gjykimi ndaj ish-katër eporëve të UÇK-së është në kilometrin e fundit dhe aktualisht po mbahen fjalët përmbyllëse.

Ky ishte vendimi i parë i legjislaturës së dhjetë të Kuvendit të Kosovës pas themelimit të organit ligjvënës një ditë më parë.

Para votimit, deputetë nga Lidhja Demokratike e Kosovës kërkuan që rezolutës t'i shtohet edhe një pikë përmes së cilës do të kërkohet zbardhja e vrasjeve para dhe pas luftës. Por, kjo u kundërshtua nga PDK-ja, dhe Përparim Gruda nga kjo parti tha se tekstin e rezolutës vetëm e kanë mbështetur dhe nuk e kanë përpiluar ata.

LDK-ja më pas nuk mori pjesë në votim.



KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS MIRATOI:

REZOLUTË

Duke rikonfirmuar përkushtimin e plotë të Kuvendit për respektimin e rendit kushtetues, përfshirë Amendamentin Nr. 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për themelimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar; Duke rikujtuar qëllimin e këtij amendamenti dhe përkushtimin e Republikës së Kosovës për të adresuar dhe demantuar akuzat e pabazuara që burojnë nga Raporti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës [Dokumenti 12462] i 7 janarit 2011, të cilat as pas një dekade hetimesh ndërkombëtare nuk kanë përbërë bazë për t'u përfshirë në aktakuzat e ngritura kundër udhëheqësve dhe luftëtarëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; Duke shprehur besimin e plotë në vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si pjesë sublimë e historisë sonë të lavdishme, mbi të cilën qëndron Republika jonë dhe duke nderuar sakrificat e burrave dhe grave të Kosovës për lirinë dhe pavarësinë e saj, siç nënvizohet edhe në preambulën e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës; Duke theksuar përkushtimin tonë të plotë për mbrojtjen e

vlerave të demokracisë, ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor, të saktësuar në Kushtetutën e Republikës sonë dhe në aktet e standardet ndërkombëtare;

Duke theksuar përkushtimin tonë të plotë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente ndërkombëtare, si Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Duke e vlerësuar të domosdoshme që të ritheksohen detyrimet që rëndojnë mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, ashtu si edhe mbi çdo institucion tjetër të Republikës së Kosovës, lidhur me zbatimin e standardeve dhe parimeve kushtetuese e ndërkombëtare për administrimin e duhur të drejtësisë;

Kuvendi i Republikës së Kosovës 1. KËRKON nga Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar që, në ushtrimin e funksioneve të tyre, të sigurojnë zbatimin me përpikëri të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës, që përmban standardet më të mira ndërkombëtare, lidhur me një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm, duke respektuar gjithashtu parimet e transparencës, llogaridhënies dhe kultivimit të besimit të publikut në drejtësi.

2. KËRKON nga Dhomat e

Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar që, në ushtrimin e funksioneve të tyre, të sigurojnë zbatimin me përpikëri të standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit dhe të tjerëve, përfshirë edhe detyrimet që burojnë nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

3. KËRKON nga Ombudspersoni i Dhomave të Specializuara, përgjegjësia ekskluzive e të cilit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar buron nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, që të veprojë me pavarësi dhe paanësi të plotë në ushtrimin e këtij funksioni, në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe aktet e standardeve ndërkombëtare lidhur me këtë funksion.

4. KËRKON nga shtetet financuese dhe mbështetëse të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë që ta respektojnë marrëveshjen me Republikën e Kosovës, që gjykata të operojë në bazë të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës, e cila në brendi i ka të gjitha standardet më të mira ndërkombëtare. Shtetet financuese dhe mbështetëse të Dhomave të Specializuara të Kosovës duhet të marrin përgjegjësi, nëse shkelen këto të drejta.

5. INKURAJON të gjitha shtetet demokratike të bashkohen në thirrjen tonë për respektimin e plotë të standardeve

ndërkombëtare për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm - standarde këto që burojnë nga tradita kushtetuese e të gjitha shteteve demokratike dhe akteve e rekomandimeve të miratuara nga mekanizmat ndërkombëtarë, përfshirë, por pa u kufizuar, nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

6. INKURAJON mekanizmat monitorues për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore në kuadër të organizatave ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare ndërkombëtare e vendore, për monitorim të shtuar të pajtueshmërisë së funksionimit të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore në procese gjyqësore dhe raportimin e shkeljeve të evidentuara.

7. KONFIRMON zotimin dhe përkushtimin për sigurimin e të gjitha mekanizmave, përfshirë ato financiare, në mbështetje të të drejtave të mbrojtjes së udhëheqësve dhe luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës para Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe Dhomave të Specializuara.

8. KONFIRMON zotimin dhe përkushtimin e plotë për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve për afirmimin e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe historisë mbi të cilën është ndërtuar Republika e Kosovës.



MBROJTJA E JAKUP KRASNIQIT NIS PARAQITJEN E DEKLARATËS PËRMBYLLËSE
NË RASTIN E LIDERËVE TË UÇK-SË

JAKUP KRASNIQI ËSHTË I PAFAJSHËM, ZPS-JA MBYLLI SYTË PARA FAKTEVE

-Avokati Dixon: Kadri Veseli duhet të lirohet dhe të shpallet i pafajshëm për të gjitha akuzat
-Avokati Roberts: Rexhep Selimi është tërësisht i pafajshëm. ZPS-ja s'ka rritur t'i provojë akuzat

Mbrojtja e Jakup Krasniqit të premten ka filluar paraqitjen e deklaratave përmbyllëse në procesin gjyqësor në Hagë dhe do të vazhdojë edhe të hënën e javës së ardhshme. Sikurse mbrojtja e Thaçit, Veselit dhe Selimit, edhe ajo e Krasniqit ka çmontuar pretendimet e ZPS-së në raport me katërshen e UÇK-së. Avokatja Venkateswari Alagendra ka vlerësuar se trupi gjykues ka para vetes vetëm një opsion: “Jakup Krasniqi të shpallet i pafajshëm”. Ajo e ka akuzuar ZPS-në se pretendimet e saj janë të mbështetura në spekulime. Po ashtu, ajo e ka akuzuar ZPS-në se ka mbyllur sytë para provave që nuk i përshtateshin asaj

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Mbrojtja e ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi, të premten pasdite ka filluar me paraqitjen e deklaratave përmbyllëse në procesin gjyqësor në Hagë. Ekipi mbrojtës i Krasniqit edhe të hënën e javës së ardhshme do të vazhdojë përgatitjen e këtyre deklaratave. Ashtu siç pritej, edhe mbrojtja e Krasniqit ka çmontuar pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Avokatja kryesore e Jakup Krasniqit, Venkateswari Alagendra, para trupit gjykues ka vlerësuar se Krasniqi është i pafajshëm. Ajo ka kërkuar nga trupi gjykues që Jakup Krasniqin ta shpallë të pafajshëm. “Parashtrojmë që është vetëm një

opsion që të merrni vendim pafajësie ndaj të gjitha akuzave të ngritura ndaj Jakup Krasniqit. Në fund të parashtrimit do t'ju bëjmë thirrje, të nderuar gjykatës, që ta shpallni të pafajshëm Krasniqin dhe ta lejoni këtë zotëri 75-vjeçar të kthehet në familjen e tij dhe të kalojë vitet që i ka caktuar Zoti me familjen e tij”, ka thënë Alagendra.

Më tutje, Alagendra e ka akuzuar ZPS-në se ka përzgjedhur dokumente dhe pjesë të dëshmive të dëshmitarëve sipas interesave të saj, duke shtuar se ka injoruar pjesët e dëshmive që nuk i përshtaten prokurorisë. Në këtë drejtim, Alagendra ka thënë se ZPS-ja nuk ua ka dhënë peshën e duhur provave shfajësuese duke përmendur shembullin e një urdhri të lëshuar nga shefi i shtabit të

UÇK-së, Bislim Zyrapi, më 28 nëntor 1998, dhe ka përzgjedhur vetëm pjesë të dëshmisë së tij dhënë prokurorisë më 2019. Zyrapi kishte thënë, sipas mbrojtjes, se urdhrin e kishte marrë pasi ishte konsultuar me komandantin e përgjithshëm Azem Syla dhe, sipas avokates, ZPS-ja ka thënë se ai kishte raportuar për këtë edhe te Krasniqi. “Ajo çfarë nuk merr parasysh Prokuroria është dëshmia e Zyrapit që komandanti i përgjithshëm Azem Syla e jo Jakup Krasniqi ishte ai me të cilin ai kishte diskutuar ankesat përpara se ta nxirrte urdhrin e 28 nëntorit 1998”, ka thënë Alagendra, duke shtuar se Zyrapi kishte konfirmuar qartësisht se ai ishte konsultuar vetëm me Sylën e jo Krasniqin.

ZPS-ja nuk ka vërtetuar lidhjen e Krasniqit me krimet e pretenduara

Avokatja Venkateswari Alagendra ka thënë se ZPS-ja mbështetet në “spekulime dhe pretendime të pambështetura” në akuzat ndaj Krasniqit. Ajo ka thënë se nuk ka asnjë dëshmitar që thotë se Krasniqi e ka keqtrajtuar. “Të nderuar gjykatës, ju kërkoj që kur t'i shqyrtoni provat e paraqitura nga Prokuroria, të mos harroni këto fakte. Në të gjitha provat nuk ka qoftë edhe një dëshmitar të vetëm që pretendon se Krasniqi e ka rrahur, e ka keqtrajtuar apo torturuar. Nuk ekziston një viktimë e vetme nga qindra dëshmitarë të Prokurorisë që pretendon ose akuzon Krasniqin që e ka rrahur, abuzuar ose ka qenë i pranishëm kur ata janë keqtrajtuar. Kjo prokurori mbështetet kryesisht në spekulime dhe pretendime të pambështetura”, ka thënë ajo. Avokatja Alagendra ka thënë se ZPS-ja nuk ka arritur ta vërtetojë lidhjen e pretenduar të klientit të saj me krimet. “Prokuroria ka dështuar ta vërtetojë lidhjen në mes të Krasniqit dhe krimeve të pretenduara, në veçanti që

komunikatat, rregulloret e hartuara nga Jakup Krasniqi, kanë ndihmuar, inkurajuar ose kanë pasur ndonjë lidhje me krimet e ngritura në aktakuzë. Në fund, Prokuroria tërhoqi pretendimin se Krasniqi ka vizituar persona që kanë qenë të ndaluar në Malishevë. Ky ishte i vetmi pretendim i ZPS-së që Krasniqi ka parë me sytë e tij një viktimë që ka qenë në ndalim. Një prokuror i përgjegjshëm nuk do të kishte ngritur kurrë një akuzë të tillë”, ka thënë ajo.

Po ashtu, ajo ka pretenduar se ZPS-ja nuk ka bërë punën siç duhet, pasi nuk ka ftuar dëshmitarë kyç që do të ofronin informacione për kontekstin e luftës dhe të ofronin informacione për hierarkinë e UÇK-së. Ajo e ka cilësuar “të shtrembëruar dhe të paplotë” dokumentacionin e ofruar nga ZPS-ja, dhe ka thënë se trupi gjykues do të përballet me hetime selektive të kryera nga organi ndjekës.

“ZPS-ja mbylli sytë para provave që nuk i përshtateshin narrativit të saj”

Më tutje, avokatja e Krasniqit, Venkateswari Alagendra, ka

thënë se ZPS-ja ka mbyllur sytë para “çdo prove që nuk i është përshtatur” narrativit të saj. Në këtë drejtim, ajo ka thënë se ZPS-ja nuk ka përfillur dëshmitë e dëshmitarëve të saj lidhur me emërimin e Jakup Krasniqit zëvendëskomandant i UÇK-së. “Trupi gjykues ka marrë dëshmi të shumta se emërimi i Krasniqit zëvendëskomandant nuk njihej në të gjitha nivelet e UÇK-së. Ai nuk njihej si zëvendëskomandant për mbështetje për ndërkombëtarët që kishte komunikim”, ka thënë se Alagendra, duke shtuar se ZPS-ja nuk i ka kundërshtuar faktet e paraqitura nga dëshmitarët. “Dëshmitarët e ZPS-së kanë konfirmuar se Krasniqi e ka mbajtur këtë pozitë për një periudhë të shkurtër kohore, përafërsisht tre muaj dhe ka dhënë dorëheqje më 27 shkurt 1999. Të njëjtët dëshmitarë të Prokurorisë thanë se emërimi i Krasniqit nuk u pranua asnjëherë, më saktë u kundërshtua nga komandantët e zonave. Prokuroria në dosje nuk i ka kundërshtuar këto fakte”, ka thënë Alagendra.

“ZPS-ja nuk vërtetoi autorësinë e materialeve të sekuestruara në shtëpinë e Krasniqit”

Mbrojtja e Jakup Krasniqit ka thënë se ZPS-ja nuk ka verifikuar autorësinë, autenticitetin apo besueshmërinë e materialeve që janë sekuestruar në nëntor të vitit 2020 në shtëpinë e klientit të tij. Avokatja Venkateswari Alagendra ka thënë se dihet që Krasniqi ka botuar libra dhe prokuroria “nuk merr parasysh provat se Krasniqi po mblidhte materiale në lidhje me UÇK-në pas luftës për të shkruar librin e tij dy dekada më parë”. Sipas saj, Krasniqi e dinte që ZPS-ja po hetonte në Kosovë shumë më herët sesa kur u ngrit aktakuza ndaj tij, dhe fakti që nuk i ka shkatërruar këto materiale që mund ta inkriminojë, duhet të shihet si pozitiv dhe pretendoi se është fakt që ai është i pafajshëm. “Nëse Krasniqi do të kishte menduar se materialet hulumtuese dhe dokumentet e tjera në shtëpinë e tij do të ishin



pjesë e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, ku dhe ai bënte pjesë, apo që ishin inkriminuese për të, pse t'i mbante ato. Fakti që i mbajti dhe nuk i shkatërroi duhen parë në favor të tij, sepse ai është i bindur që është i pafajshëm”, ka thënë ajo, duke akuzuar ZPS-në se ka shtrembëruar fjalën hyrëse të Krasniqit, duke thënë se ai ka pranuar se dokumentet ishin të tij. “Ai asnjëherë nuk ka thënë se materialet e gjetura në shtëpinë e tij kanë qenë të shkruara prej tij. Ai, në fakt, ka pranuar se ka bërë disa shënime për të shkruar një libër, por kjo nuk do të thotë se domosdoshmërisht materialet ishin për konfliktin. I përket Prokurorisë të vërtetojë se këto dokumente lidhen me akuzat, përfshirë autorësinë e Krasniqit dhe ta vërtetojnë autenticitetin dhe besueshmërinë e dokumenteve, diçka që nuk e kanë bërë deri më tani”, ka thënë Alagendra.

Mbrojtja e Krasniqit: Dokumentet serbe ishin të fabrikuara

Avokatja Venkateswari Alagendra ka thënë se materialet e marra nga Serbia kundërshtoheshin nga verifikimet në terren. “Gjykatësit duhet t'i trajtojë si materiale me interes, jo si provë nëse nuk janë të provuara. Materiale të tilla janë fabrikime të skenave të krimeve nga

autoritetet serbe. Fred Abrahams e bëri të qartë dallimin mes medias së pavarur dhe medias shtetërore duke iu referuar masakrës në Obri dhe HRW-ja tha se ka shkelje serioze të rregullave të luftës”, ka thënë ajo. Alagendra ka thënë se disa dëshmitarë kanë treguar për pasaktësinë e dokumenteve zyrtare serbe. Disa, tha ajo, kishin dëshmuar se nuk kishin thënë ashtu siç paraqitej në dokumente, disa thoshin se janë shtuar pjesë në dëshminë e tyre. Ajo, po ashtu, i bëri thirrje trupit gjykues të ketë parasysh se Serbia ka përdorur “torturë” gjatë marrjes në pyetje të shqiptarëve.

Mbrojtja e Selimit konteston dëshmitarët e ZPS-së: Gënjyen para trupit gjykues

Mbrojtja e ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, Rexhep Selimi, ka përfunduar deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor në Hagë. Për dy ditë me radhë avokatët e Selimit kanë çmontuar pretendimet e ZPS-së në raport me klientin e tij, duke kërkuar nga trupi gjykues të marrë vendim lirues për “10”-shin e UÇK-së. Në ditën e parë të paraqitjes së deklaratës përfundimtare, avokati kryesor i Selimit, Geoffrey Roberts, ka vënë në dyshim besueshmërinë e dëshmitarëve

të ZPS-së për disa incidente që e lidhin klientin e tij me krime të pretenduara, sikurse ndalimi dhe kërcënimi i personave të ndryshëm. Ai ka thënë se për një incident të prillit të vitit 1999 në Kleçkë, ZPS-ja është mbështetur në një dëshmitar, i cili ka “shpikur historinë” se ishte takuar me Selimin, prandaj ka arritur ta identifikonte më pas. Për një dëshmitar tjetër, Roberts, ka thënë se ka histori të rrëfimeve të pavërteta para ZPS-së, në bazë të interesave të tij. Ai ka mohuar se ka prova që Selimi është përfshirë në incidentin e Qirezit, përkatësisht ndalimit të disa anëtarëve të UÇK-së, e as në ndalimin e Blerim Kuçit. Po ashtu, Roberts ka përmendur një incident në Likoc në gusht të 1998-s, ku ZPS-ja pretendon se Selimi ka marrë pjesë në marrjen në pyetje të një të ndaluari. Avokati Roberts ka thënë se ky dëshmitar e ka gënjyer trupin gjykues. “Kompensimi financiar që dëshmitari i ka pranuar ZPS-së, se ishte i interesuar, duket se të ketë mjaftuar që ky dëshmitar ta gënjente sy për sy trupin gjykues”, ka thënë Roberts. Ndërsa në dytën e dytë disa nga avokatët e Selimit kanë paraqitur deklaratat përmbyllëse. Ata kanë thënë se nuk ka asnjë provë inkriminuese për Selimin. Ndërsa avokati tjetër i Selimit, Chad Mair, ka thënë se në UÇK nuk ishte strukturë komanduese. “Shumë ushtarë të UÇK-së, përfshirë komandantët, nuk

dinin as për ekzistencën e Shtabit të Përgjithshëm apo anëtarëve të tyre. Vetë zonat ishin në formim e sipër, të paformuara në pjesën e parë të vitit 1998. Nuk kishte strukturë me zinxhir komandues, kishte grumbullim njësitësh lokale, njësitësh guerile që vepronin në mënyrë të pavarur dhe horizontale, pa ndonjë kohezion dhe uniformitet. Brenda Shtabit të Përgjithshëm në këtë pikë kohore nuk kishte strukturë komanduese të vërtetë dhe nuk kishte përcaktim të qartë të përgjegjësive”, ka thënë Mair. Kurse avokati tjetër i Selimit, Eric Tully, ka argumentuar se klienti i tij nuk kishte kontroll mbi policinë ushtarake. “Ekziston një mungesë e tërë e dokumenteve operative të dërguara nga Ministria e Rendit Publik në drejtim të policisë ose, e kundërta, gjë e cila nuk vërteton përfshirjen e zotit Selimi, apo që ai ka pasur kontroll mbi policinë. Prokuroria nuk ka dhënë prova për të vërtetuar që veprimet ose mosveprimet e zotit Selimi si ministër i Rendit Publik kanë luajtur ndonjë rol në kryerjen e krimeve në aktakuzë dhe që ai është përgjegjës për veprimet e personave të tjerë lidhur me kryerjen e krimeve të pretenduara në aktakuzë”, ka thënë ai. Edhe avokatja tjetër e Rexhep Selimit, Furtuna Sheremeti, ka theksuar se ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë provë se Selimi ka pasur njohuri apo kontroll efektiv që ka të bëjë me përgjegjësinë komanduese në UÇK. “Po të ketë pasur një rrjet komandimi që do të çonte drejt zotit Selimi do të kishte dalë nga provat. Por nuk ka ndodhur një gjë të tillë”, ka thënë Sheremeti. Dhe në fund të deklaratës përfundimtare, avokati kryesor i Selimit, Geoffrey Roberts, ka thënë se trupi gjykues do të arrijë në përfundimin që klienti i tij është i pafajshëm nëse shikon tërësinë e provave. “Selimi nuk ka qenë komandant. Nuk ka ushtruar asnjë përgjegjësi eprorë në asnjë mënyrë dhe asnjë formë. Këtu përfshihet edhe autoriteti i pretenduar se Selimi ka qenë anëtar i këtyre strukturave pavarësisht se ai që në fillim ka qenë një anëtar i njohur i UÇK-së”, ka thënë Roberts.

GRENELLI MBËSHTET PAFAJËSINË E THAÇIT, VESELIT, KRASNIQIT DHE SELIMIT

Prishtinë, 13 shkurt - I dërguari special i presidentit amerikan Donald Trump për misionet e speciale të ShBA-së, Richard Grenell, ka shprehur mbështetjen mbi pafajësinë e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit. Këtë e ka bërë me dije kreu i Grupit të Partisë Socialiste në Shqipëri, Taulant Balla. Ky i fundit ka thënë se me Grenellin

ka pasur një drekë pune në kuadër të Konferencës së Sigurisë Mynih. “Konferenca e Sigurisë Mynih. Drekë pune me Richard Grenell, të Dërguarin Special të Presidentit Donald Trump për Misionet Speciale të ShBA. Diskutuam mbi partneritetin e veçantë mes Shqipërisë dhe ShBA. Ftesa për kryeministrin Rama në Bordin e Paqes të iniciuar nga presidenti Trump e ka ngjitur Shqipërinë në

nivelin më të lartë të vendimmarrjes, aty ku diskutohen politikat globale të paqes dhe garantimi i saj përmes sigurisë. Shqipëria shihet sot si aktor që kontribuon në zgjidhje globale, jo thjesht si pjesë periferike e tyre. Mirënjohje të Dërguarit Special Grenell për mbështetjen mbi pafajësinë e presidentit Thaçi dhe drejtuesve të UÇK-së”, ka shkruar Balla në “Facebook”.



Mimoza Kusari pas 15 viteve rikthehet në krye të Ministrisë së Tregtisë

Prishtinë, 13 shkurt - Të premten zyrtarisht Mimoza Kusari ka pranuar detyrën nga ministrja e deritashme dhe deputetja e zgjedhur e Kuvendit të Kosovës, Rozeta Hajdari. Ajo ka bërë me dije se pas 15 viteve rikthehet në krye të Ministrisë së Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Inovacionit. “E bindur se

me përkushtim, energji dhe vizion do të vazhdojmë drejt një ekonomie të qëndrueshme, me politika mbështetëse për sektorin privat, start-up-et, fuqizimin ekonomik të grave, forcimin dhe brendimin e produkteve ‘Made in Kosova’, si dhe ngritjen e eksportit dhe rritjen e produktivitetit të prodhimit

kosovar. Incentivizimi i bizneseve për të punuar me politka miqësore mjedisore, duke promovuar ekonominë qarkore, do të kenë fokusin tim të veçantë. Vendi ynë pasurinë më të çmuar i ka të rejat dhe të rinjtë, të cilët me kreativitetin dhe talentin e tyre kanë zhvilluar dhe rritur sektorin e inovacionit - sektor

që tashmë është pjesë e këtij dikasteri. Dialogu publiko-privat dhe sinergia e krijuar përmes ndërlidhjes dhe koordinimit të të gjithë sektorëve do të sjellin vlerë të shtuar për ekonominë e vendit. E lumtur të jem pjesë e zhvillimit dhe suksesit të shtetit tonë”, ka shkruar Kusari në “Facebook”.



NË GJYQIN KUNDËR UÇK-së: SHQIPTARI I LOPËS DHE MËZATIT NË GJYKATËN E HAGËS...

Luan RAMA

E kam parë dhe dëgjuar edhe unë. Dhe si unë, e kenë parë dhe dëgjuar edhe shumë prej jush me siguri atë njeriun që fliste shqip m’u përpara Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit në sallën e gjyqit në Gjykatën e Hagës.

Qurravitej, ankohej dhe akuzonte si qurrash se gjatë kohës së luftës së UÇK-së për çlirimin e Kosovës, një shqiptar tjetër, i kishte vjedhë lopën me gjithë mëzat!

Po, po, lopën dhe mëzatin! Dhe për lopën dhe mëzatin e vjedhur, fajin e ka Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi. Fajin e ka UÇK. Fajin e ka edhe Adem Jashari me gjithë familjen e vranë e djegur nga serbët në kullën e Prekazit! Fajin e kanë edhe mijëra shqiptarë të tjerë të vranë e masakruar.

Ai, shqiptari i lopës dhe mëzatis



ishte a është dëshmitar i akuzës. Domethënë dëshmitar i prokurorëve të zyrës speciale, i atyre që për Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin, kërkuan dënimin me nga 45 vjet burg për secilin.

Ai, shqiptari i lopës dhe mëzatis ishte a është dëshmitar i prokurorëve të zyrës speciale kundër dëshmitarëve të Hashim Thaçit dhe të të gjithë UÇK-së; kundër Gjeneralit

Klark, kundër James Rubin, kundër ambasadorit Hill e gjithë ndërkombëtarëve të tjerë, kundër NATO-s! Shqiptari i lopës dhe mëzatis, dhe si ai edhe nja njëqind a më shumë të tjerë që shkuan dëshmitarë të akuzës, edhe ata të lopës dhe mëzatis, janë në fakt jo vetëm fytyra e shqiptarëve që shkuan në Hagë për të akuzuar e vranë UÇK-në, por edhe fytyra e të gjithë atyre shqiptarëve të tjerë të lopës dhe

mëzatis, që mbllaçiten e vjellin ekraneve e studiove televizive në Prishtinë e Tiranë si jugosllavët e shekullit tonë, mbetur e mbajtur nga Serbia pikërisht për të bërë atë që regjimit i Millosheviqit nuk e bëri dot me luftë; burgosjen, dënimin dhe vrasjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Këta, shqiptarët e lopës dhe mëzatis, duan që gjakun e derdhur për lirinë e Kosovës ta zhbëjnë e zëvendësojnë me shurrën e lopës dhe mëzatis të tyre.

Sepse këtë e do edhe Serbia! Këta, shqiptarët e lopës dhe mëzatis, duan që dëshmorët e UÇK-së që u flijuan për lirinë e Kosovës të nxirren nga varret dhe eshtrat e tyre të zëvendësohen me kockat e lopës dhe mëzatis të tyre.

Sepse, këtë e do edhe Serbia! Këta, shqiptarët e lopës dhe mëzatis, duan që pranë varreve të dëshmorëve të lirisë të mos valëvitet flamuri i kombit, por në vend të tij të vendoset lëkura

e lopës dhe mëzatis të tyre. Sepse këtë e do edhe Serbia! Këta, shqiptarët e lopës dhe mëzatis, duan që të mos këndohet më “Marshi i UÇK-së” por në vend të tij këta jugosllavët e shekullit tonë që mbllaçiten e vjellin ekraneve e studiove televizive në Prishtinë e Tiranë, të pëllasin pëllitjet e lopës dhe mëzatis të tyre.

Sepse këtë e do edhe Serbia! Shqiptari i lopës dhe mëzatis është në Gjykatën e Hagës. Kundër Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit. Edhe kundër UÇK-së!

Sepse këtë e do edhe Serbia! Shqiptari i lopës dhe mëzatis është përnatë me zë e me figurë edhe nëpër ekrane televizioni e flet për krimet e luftës së UÇK-së e drejton gishtin kundër Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit.

Sepse këtë e do edhe Serbia! Jo vetëm liria ka emër. Edhe tradhtia ka emër!

DEPUTETËT RATIFIKOJNË DISA MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE

PRISHTINË, 13 SHKURT - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë ratifikuar marrëveshjen ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimi Evropian mbi aranzhimet për zbatimin e përkrahjes së Unionit për Kosovën në kuadër të instrumentit për reforma dhe rritje. Marrëveshja është miratuar me 104 vota për, asnjë kundër dhe pesë abstenime. Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se nga kjo

marrëveshje Kosova pritet të përfitojë 882.6 milionë euro. Po ashtu, deputetët e Kuvendit kanë ratifikuar marrëveshjen e Financimit për Programin e parë për “Financimin e Politikave Zhvillimore për Efektivitetin Fiskal, Konkurrueshmërinë dhe Rritjen e Gjellbër” ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Asociacionit



Ndërkombëtar për Zhvillim (pjesë e Grupit të Bankës Botërore); marrëveshjen e Kredisë për “Instrumentin për

Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor” ndërmjet Bashkimit Evropian, që përfaqësohet nga Komisioni Evropian si Huadhënës, dhe Republikës së Kosovës si Huamarrës, dhe Bankës Qendrore të Kosovës si Agjent i Huamarrësit, 5; marrëveshjen e Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim për

projektin “Kompas” - Qasja gjithëpërfshirëse e Kosovës për forcimin e sistemit të shëndetësisë” dhe marrëveshjen e kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (ANZh) për projektin “Edukimi në fëmijërinë e hershme dhe kujdesi për kapitalin njerëzor të Kosovës”.

Krasniqi pret në takim kryetarët e dhjetë komunave me shumicë serbe

PRISHTINË, 13 SHKURT - Elbert Krasniqi, ministër i Administrimit dhe Pushtetit Lokal, ka njoftuar se për t’i koordinuar përgjegjësitë institucionale në mes të dy niveleve, ka pritur të premten në takim kryetarët e dhjetë

komunave me shumicë serbe. “Gjatë këtij takimi kam dëgjuar me kujdes secilin kryetarë të komunës, për çdo sfidë të tyre. Qeveria në përgjithësi dhe MAPL në veçanti është e gatshme të ofroj ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme për zgjedhjen e

problemeve të cilat janë me interes për qytetarët. Ky takim i sotëm është një nga forumet për komunikim e koordinim me komunat, përfshirë atë ku bëjnë pjesë 38 komuna, si platformë më e mirë për komunikim e koordinim ndërmjet nivelit

qendror dhe atij lokal. Takimet e radhës me agenda konkrete e të detajuara do të vazhdojnë, në interesin më të mirë të qytetarëve të Republikës, përmes bashkëpunimit të nivelit qendror dhe atij lokal”, ka shkruar ai në “Facebook”.



Vasfije Krasniqi mbështet marshin “Drejtësi, jo politikë”

PRISHTINË, 13 SHKURT - E mbijetuara e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, Vasfije Krasniqi, ka shprehur mbështetjen e saj për marshin qytetar “Drejtësi, jo politikë”, të organizuar nga platforma “Liria ka Emër”, i cili do të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, në

mbrojtje të çlirimtarëve që po përballen me një proces të padrejtë gjyqësor në Hagë. Vasfije Krasniqi do të jetë një nga folëset që do të mbajë fjalim gjatë këtij marshi. Ajo ka deklaruar se është obligim moral dhe njerëzor për të marshuar për të vërtetën e luftës çlirimtare të popullit të

Kosovës dhe për drejtësinë e mohuar për vite me radhë. “Më 17 shkurt do të jem pjesë e protestës “Drejtësi, jo politikë”. Si e mbijetuar e krimeve të Serbisë që kam kërkuar drejtësi, e ndiej si detyrim moral dhe njerëzor të marr pjesë për të vërtetën, dinjitetin dhe për drejtësinë e

cila u është mohuar viktimave për vite me radhë, përfshirë edhe mua. Pa drejtësi nuk ka paqe!”, ka thënë Krasniqi. Platforma “Liria ka Emër” falënderon të gjithë qytetarët, organizatat, grupet shoqërore dhe komunitetet në vend dhe përtej për



mbështetjen dhe gatishmërinë për ta ndihmuar kauzën për drejtësi të paanshme.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 SHKURT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka njoftuar se nuk do të kandidojë për udhëheqjen e partisë në zgjedhjet e brendshme partiake. Pas mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm të AAK-së, Haradinaj tha se zgjedhjet partiake do të mbahen nga 20 shkurti deri më 7 qershor. Ai i falënderoi të gjitha strukturat e Aleancës në të gjitha nivelet për angazhimin dhe përkushtimin e deritanishëm, duke shprehur bindjen se pas përfundimit të zgjedhjeve të brendshme, Aleanca do të dalë edhe më e fortë dhe më e përgatitur në sfidat që e presin. I pyetur nëse do të jetë kandidat për president, Haradinaj tha se nuk është. Haradinaj është zgjedhur deputet i legjislaturës së dhjetë

që u konstituua një ditë më parë. Ndërkaq, në zgjedhjet e dhjetorit ai ishte kandidat i AAK-së për kryeministër. Në të kaluarën Haradinaj ka shërbyer dy herë kryeministër i Kosovës. Ndërkaq, për qëndrimin e partisë lidhur me votimin e Vjosa Osmanit për një mandat të dytë si presidente, Haradinaj tha se AAK-ja ende nuk ka vendosur për këtë çështje. Ndërkaq, nënkryetari aktual i partisë, Ardian Gjini, ka bërë me dije kandidaturën për kryetar të Aleancës, duke mirëpritur njëkohësisht edhe kandidaturat e tjera, në frymën e demokracisë së brendshme dhe garës së hapur brenda partisë. Në përputhje të plotë me Statutin e partisë, fillimisht anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm votuan në mënyrë unanime për formimin e Komisionit të Përzgjedhjes dhe Kandidatëve dhe Nominime, Komisionit Statutar, Komisionit të Etikës, si dhe për plotësim-



ndryshimin e Rregullores për Zgjedhjet në AAK. Në vijim të takimit u votua edhe për formimin e Komisionit të Organizimit dhe Koordinimit të Zgjedhjeve të Brendshme,

duke i hapur rrugë shpalljes zyrtare të procesit zgjedhor brenda Aleancës. Në mbështetje të Statutit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Këshilli i Përgjithshëm

mori vendim që kuvendet e nëndegëve të mbahen nga data 20 shkurt 2026 deri më 31 mars 2026, ndërsa Kuvendi i Përgjithshëm të mbahet më 7 qershor 2026.

56-VJETORI I UP-së: NDEROHEN PROFESORËT DHE PUNËTORËT ADMINISTRATIVË QË PËRFUNDUAN PUNËN



Prishtinë, 13 shkurt - 22 profesorë dhe 4 punëtorë të administratës që do ta përfundojnë karrierën e tyre akademike dhe punën gjatë këtij viti janë nderuar me mirënjohje në 56-vjetorin e UP-së. Mirënjohjet profesorëve që arritën moshën e pensionimit iu dhanë për një jetë të tërë mësimdhënie dhe edukimi të gjeneratave të shumta të studentëve, ndërsa punëtorëve të administratës për punën e palodhshme në shërbim të UP-së.

Mirënjohjet profesorëve dhe punëtorëve të administratës ua dha rektori, prof. Arben Hajrullahu. Gjatë kësaj ceremonie solemne, rektori Hajrullahu i falënderoi profesorët dhe punëtorët e administratës që punuan për universitetin dhe të mirën e përgjithshme. Ai u bëri thirrje këtyre punëtorëve që të mos e ndalin punën edhe pas pensionimit zyrtar, derisa konstatoi se UP-në po e lënë në gjendje shumë më të mirë sesa në kohën kur e

morën detyrën. Një pllakate e veçantë iu dhurua punëtore në Administratën Qendrore të UP-së, Sebahate Nezirit, për përkushtimin e jashtëzakonshëm në punë. Universiteti i Prishtinës edhe vitin e kaluar ka nderuar punëtorët që kanë dalë në pension. Universiteti i Prishtinës, më i madhi, më i vjetri dhe më i rëndësishmi institucion i arsimit të lartë në Kosovë e përtej, ka një personel prej mbi 1 000 personash.

Osmani rithekson përkushtimin e palëkundur të Kosovës në koordinim të plotë me ShBA-në

Prishtinë, 13 shkurt - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka prituri në takim të ngarkuarën me punë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Anu Prattipati. Gjatë takimit u diskutua për zhvillimet e fundit politike në vend,

përfshirë konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë, me theks në rëndësinë e përmbylljes së proceseve kushtetuese dhe konsolidimit të plotë institucional, në funksion të stabilitetit demokratik, zhvillimit të vendit dhe

adresimit të nevojave të qytetarëve. Në takim u diskutua edhe për rolin e Kosovës në Bordin e Paqes si dhe për hapat e mëtejshëm në këtë drejtim. Në këtë kontekst, presidentja Osmani ritheksoi përkushtimin

e palëkundur të Republikës së Kosovës për linjëzim të plotë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në përputhje me interesat strategjike të vendit, si dhe për thellimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve.



Deputetët miratojnë zgjatjen buxhetore për muajin mars

PRISHTINË, 13 SHKURT - Deputetët e legjislaturës së dhjetë kanë mbështetur propozimin e qeverisë për zgjatjen buxhetore për muajin mars nga buxheti i vitit të kaluar. Ministri i Financave, Hekuran Murati, tha se për shkak të mosmiratimit të buxhetit të ri për këtë vit, kjo zgjatje është e nevojshme që të mos ketë ndërprerje në pagat e punëtorëve të sektorit publik dhe pagesave të tjera. Propozimi u përkrah nga 99

deputetë të Kuvendit. Qeveria e re e zgjedhur më 11 shkurt ka proceduar në Kuvend projektbuxhetin për këtë vit. Megjithatë, ai ende nuk është shqyrtuar nga legjislatura e re. Kjo është hera e dytë brenda pak muajsh që shteti ka financuar pagat përmes zgjatjeve buxhetore. Nëntorin e vitit të kaluar, bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, u aktivizua një nen i këtij ligji që shteti të ketë buxhet për dy muajt e

parë të vitit 2026. Ky nen u aktivizua pasi u shpallën zgjedhjet dhe ligji parasheh ndarje buxhetore kur zhvillohen zgjedhje më pak se katër muaj para vitit të ri fiskal, apo 1 janar. Ndërkaq, buxheti i ri i shtetit për vitin 2026, sipas qeverisë së udhëhequr nga Albin Kurti, pritet të jetë në vlerë rreth 4 miliardë eurosh. Po gjatë seancës së parë të legjislaturës së re deputetët kanë votuar edhe përbërjet e 16 komisioneve parlamentare.



FMN-ja VLERËSON PERFORMANCËN EKONOMIKE DHE STABILITETIN FINANCIAR TË KOSOVËS

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, së bashku me ministrin e Financave, Hekuran Murati dhe shefin e Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për Kosovën, David Amaglobeli, u paraqitën të premten para medieve për t'i paraqitur konkluzionet e Misionit të rishikimit sipas nenit IV, i zhvilluar në Kosovë nga 3 deri më 13 shkurt 2026. Në fjalën e tij, guvernatori Ismaili falënderoi FMN-në për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe mbështetjen profesionale, duke theksuar se diskutimet gjatë misionit janë fokusuar në zhvillimet makroekonomike dhe financiare, perspektivën ekonomike dhe prioritetet e politikave në sektorin financiar. Ai vlerësoi se ekonomia e Kosovës vazhdon të paraqesë qëndrueshmëri dhe ecuri pozitive, duke ndjekur një trajektore të qëndrueshme të rritjes, pavarësisht prej sfidave dhe rreziqeve të jashtme që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme. Sektori financiar, veçanërisht ai bankar, mbetet i qëndrueshëm, i kapitalizuar mirë, me likuiditet të lartë dhe me nivel të ulët të kredive joperformuese. Guvernatori Ismaili theksoi se kreditimi bankar ka shënuar rritje vjetore prej 14.7 %, ndërsa depozitat janë rritur 13 %. Kreditë joperformuese mbeten në nivel të ulët prej 2.1 %, të mbështetura nga niveli i lartë i



provizionimit. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ka arritur në 17.2 %, mbi kërkesën rregullative prej 14 %, ndërsa treguesit e likuiditetit (LCR dhe NSFR) mbeten dukshëm mbi kufijtë e përcaktuar rregullativë. Duke folur për reformat, guvernatori Ismaili informoi se BQK-ja ka bërë përparim të rëndësishëm në zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të nenit IV. Në fushën e mbikëqyrjes bankare është finalizuar drafti i parë i Manualit të SREP-it dhe janë zhvilluar instrumente të avancuara për

vlerësimin e rreziqeve dhe automatizimin e proceseve mbikëqyrëse. Ai theksoi se miratimi dhe publikimi i Ligjit të ri për Bankat përbën një reformë madhore, e cila forcon qëndrueshmërinë e sektorit bankar dhe përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt integritimit në Bashkimin Evropian. Ky Ligj është zhvilluar me mbështetjen e FMN-së në kuadër të konsultimeve të Nenit IV, Marrëveshjes Stand-By (SBA) dhe Instrumentit për Reziliencë dhe Qëndrueshmëri (RSF), të përfunduara me sukses vitin e kaluar.

Në aspekt të stabilitetit financiar dhe në fushën e menaxhimit të krizave, po finalizohet korniza e rishikuar për Mbështetjen e Likuiditetit Emergjent, ndërsa Ligji i ri për Sigurimin e Depozitave pritet të avancojë me mbështetjen e Bankës Botërore. Gjithashtu, po forcohet korniza makroprudenciale dhe kapacitetet analitike përmes zhvillimit të modeleve të reja makroekonomike dhe projekteve shumëvjeçare të asistencës teknike me FMN-në. Në aspektin e qeverisjes dhe transparencës, shumica e rekomandimeve të Vlerësimit të

Masave Mbrojtëse (Safeguards Assessment) janë zbatuar, ndërsa raporti i vlerësimit sipas Kodit të Transparencës së Bankave Qendrore (CBT) së FMN-së është në fazë përfundimtare, me vlerësime të larta për BQK-në. Sa i përket sistemit të pagesave, BQK-ja ka harmonizuar kornizën rregullative me legjislacionin e BE-së dhe ka dorëzuar para-aplikimin në DG FISMA. Ligji për Shërbimet e Pagesave dhe ai për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit do të riinicohen për miratim në Kuvend, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Paralelisht po zhvillohet sistemi i pagesave të menjëhershme (TIPS Clone) si pjesë e modernizimit të infrastrukturës së pagesave. Guvernatori Ismaili informoi gjithashtu për përparimin në rregullimin e krypto-aseteve, përfshirë miratimin e Rregullores për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Kripto-Aseteve dhe përcaktimin e afatit 1 mars 2026 për aplikim nga ofruesit ekzistues dhe potencialë dhe përshtatje me rregullativën në fuqi. Në përmbyllje, guvernatori i BQK-së theksoi se përparimi i arritur në stabilitetin financiar, mbikëqyrjen, sistemin e pagesave, qeverisjen, integritetin financiar dhe harmonizimin me standardet e BE-së dëshmon përkushtimin e BQK-së për ndërtimin e një sistemi financiar të qëndrueshëm, transparent dhe modern, në funksion të rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe prosperitetit të vendit.


Kosova në fokus të investimeve amerikane, Zeka diskuton me Departamentin e Shtetit

Prishtinë, 13 shkurt - Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, pati një takim produktiv me Lyn Debevoise, zëvendës drejtor për Çështjet e Evropës Perëndimore dhe Qendrore në Departamentin

e Shtetit Amerikan, duke paraqitur prioritetet kryesore të avokimit të Odës Amerikane. Diskutimi u përqendrua në forcimin e atraktivitetit të Kosovës për investimet amerikane, avancimin e prioritetëve të

politikave që lidhen me energjinë dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor, si dhe theksimin e rëndësisë së një angazhimi më aktiv dhe të strukturuar publiko-privat. Zeka shprehu vlerësimin e Odës Amerikane për

mbështetjen dhe angazhimin e vazhdueshëm të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në të gjitha përpjekjet e Odës Amerikane, duke përfshirë agjendën e sovranitetit digjital të Kosovës.



RRJETA E MERIMANGËS E JEFFREY EPSTEINIT: PUSHTET, PARA DHE SEKRETE

Rrjeta e Jeffrey Epstein përfshinte politikanë, miliarderë, shkencëtarë dhe figura të showbiz-it, duke krijuar një ekosistem pushteti dhe sekreti me pasoja globale

**Një ekosistem mes
parasë dhe pushtetit**

Rrjeti i ndërtuar nga Jeffrey Epstein përfaqësonte një ekosistem të vendosur në kryqëzimin mes parasë, pushtetit, ndikimit dhe fshehtësisë. Në qendër të tij ishte akses i drejtpërdrejtë tek politikanë, familje mbretërore, financierë, shkencëtarë, figura të medias dhe kulturës.

Ishte një ambient ku shantazhi shpesh nuk ishte i nevojshëm, sepse marrëveshja e heshtur për diskrecion ishte pjesë e sistemit. Marrëdhëniet ndërtoheshin mbi besimin e ndërsjellë se sekretet do të mbeteshin të tilla.

Dokumentet e publikuara tregojnë se kontaktet e Epstein ishin jashtëzakonisht të larmishme. Mes emrave të përmendur gjenden Noam Chomsky, Steve Bannon, Stephen Hawking.

Shkëmbimet e email-eve përfshinin tema që varionin nga çmimi i naftës, investimet globale dhe matematika, deri tek komente vulgare për gratë dhe diskutime mbi menaxhimin e mediave.

**Abuzimi dhe “mali i
shkëmbimit”**

Brenda këtij universi, sipas dokumenteve të konsultuara nga kongresmeni Jamie Raskin, gratë shpesh përdorëshin si “mall shkëmbimi”. Në disa raste përmenden edhe vajza shumë të reja, madje referenca për një fëmijë nëntëvjeçar. Në një email të tetorit 2012, Boris Nikoliç, këshilltar shkencor i Epstein, i shkruan: “Të lutem, përgatite vajzën”. Vajza në fjalë u prezantua tek Kimbal Musk, vëllai i Elon Musk, me të cilin pati një lidhje disa mujore, ndërsa vazhdonte t’i përcillte Epsteinin mesazhet private që merrte.

**Politika dhe financa:
emra të fuqishëm**

Mes figurave më të njohura që shfaqen në dokumente janë Bill Clinton dhe Donald Trump.

Clinton shfaqet në fotografi në avionin privat të Epstein, dhe në ambiente private,



ndërsa në shtëpinë e financierit ndodhej edhe një pikturë e ish-presidentit i veshur si grua. Trump, me ose pa Melanian, shfaqet në festa të ndryshme të organizuara në praninë e vajzave të reja. Ish-kryeministri izraelit Ehud Barak përmendet mijëra herë në dosje, me një miqësi të bazuar në muzikë, matematikë dhe investime ndërkombëtare.

Në Britani, Peter Mandelson rezultoi të ketë qenë shpesh mysafir në shtëpinë e Epstein dhe i përfshirë në shkëmbim informacionesh financiare të ndjeshme. Edhe Larry Summers, ish-sekretar i Thesarit dhe ish-president i Harvardit, kishte një miqësi shumëvjeçare me Epsteinin, duke i kërkuar

madje edhe këshilla sentimentale.

**Kompanitë e
mëdha teknologjike dhe
miliarderët**

Marrëdhënia me Bill Gates dokumentohet me fotografi dhe email-e. Ish-bashkëshortja e tij, Melinda, e ka përkrahur Epsteinin si “personifikim i të keqes”. Në një email të vitit 2012, Elon Musk pyet për festat në ishullin privat të Epstein, Saint James, edhe pse më vonë ka mohuar praninë e tij atje. Mes kontakteve të tjera në botën e teknologjisë përmenden Mark Zuckerberg, apo Peter Thiel.

Showbiz dhe kultura

Në evente sociale me Epstein dhe bashkëpunëtoren e tij Ghislaine Maxwell shfaqen figura si Mick Jagger, David Copperfield, Michael Jackson, Naomi Campbell. Po ashtu, regjisorë dhe aktorë të njohur shfaqen në darka dhe aktivitete private në rezidencën e tij në Nju Jork.

**Familjet mbretërore dhe
akuzat më të rënda**


Rrjeti përfshinte edhe figura mbretërore, si Mohammed Bin Salman, apo Mette-Marit. Por figura më e përfolur është Prince Andrew, i cili hyri në kontakt me Epsteinin përmes Ghislaine Maxwell. Ai u përball

me akuza nga Virginia Giuffre, e cila deklaroi se ishte dhënë tek ai nga Epstein, kur ishte vetëm 17 vjeç.

Një rrjet që tronditi botën

Rrjeta e Jeffrey Epstein nuk ishte thjesht një rrjet social elitë. Ishte një strukturë ndikimi që lidhte politikën, financën, teknologjinë, akademinë dhe showbiz-in, me sekrete që vazhdojnë të dalin në dritë përmes dokumenteve të reja.

Rasti mbetet një nga skandalet më të mëdha globale, sepse nuk ka të bëjë vetëm me një individ, por me një sistem marrëdhëniesh ku pushteti dhe heshtja funksiononin paralelisht. / bota.al



KOSOVA NË GRUPIN B3 TË LIGËS SË KOMBEVE

Kombëtarja e Kosovës ka mësuar kundërshtarët për edicionin e ri të Ligës së Kombeve. “Dardanët” do të garojnë në Ligën B, Grupin B3, ku do të përballen me Izraelin, Austrinë dhe Republikën e Irlandës. Ndeshjet e edicionit të pestë të Ligës së Kombeve janë të planifikuara të zhvillohen nga shtatori deri në nëntor dhe do të ofrojnë sfida të forta për Kosovën në rrugëtimin ndërkombëtar. Pas tërheqjes së shortit, presidenti i FFK-së, Agim Ademi dhe përzgjedhësi i Kombëtares, Franco Foda, kanë thënë Kosova është pjesë e një grupi të fortë, por do të synojnë rezultate pozitive

BRUKSEL, 13 SHKURT - Kombëtarja e Kosovës ka mësuar kundërshtarët për edicionin e ri të Ligës së Kombeve të UEFA-s i cili do të nisë në muajin shtator. Në shortin e hedhur në Bruksel për Ligën B, Kosova është vendosur në Grupin B3, së bashku me Izraelin, Austrinë dhe Republikën e Irlandës. “Dardanët” janë përballur edhe më herët me Izraelin, ndërsa ndeshjet me Austrinë dhe Republikën e Irlandës do të jenë përballjet e para në histori. Në veçanti, ndeshjet ndaj Austrisë pritet të jenë të veçanta, pasi përzgjedhësi i Kosovës, Franco Foda, e ka drejtuar më parë këtë kombëtare. Në ceremoninë e shortit në Bruksel ishte i pranishëm edhe delegacioni i Federatës së Futbollit të Kosovës në krye me presidentin Agim Ademi dhe përzgjedhësin Franco Foda.

Ademi dhe Foda pas shortit: Grup i fortë, objektiv ruajtja e nivelit

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi dhe përzgjedhësi i Kombëtares, Franco Foda, kanë dhënë deklaratat e tyre pas tërheqjes së shortit për edicionin e ri të Ligës së Kombeve, ku Kosova është pjesë e Grupit 3 të Ligës B, së bashku me Austrinë, Izraelin dhe Irlandën. Presidenti Ademi ka vlerësuar se shorti nuk është i lehtë, por ka thënë se Kosova tashmë i përket një niveli tjetër dhe se nuk ka më kundërshtarë të dobët në këtë nivel të garës. “Shorti normalisht se është jo i lehtë, mirëpo ne tashmë jemi në Ligën B dhe nuk ka kundërshtarë të dobët. Por



edhe ne si Kosovë tanimë jemi në nivel tjetër dhe duke pasur parasysh këtë fakt mendoj se në këtë grup mund t’ia dalim, edhe pse do të përballemi me skuadra që nuk i njohim shumë, pasi me Austrinë dhe Irlandën nuk kemi luajtur deri tash. Ndërkohë, kundër Izraelit kemi luajtur dhe e njohim. Sidoqoftë besoj se meqenëse Foda ka punuar në kombëtaren e Austrisë e njeh si karakter dhe do t’ia dalim disi. Për ne me rëndësi është që ekipi ynë të jetë në formë të mirë dhe të japim më të mirën e mundshme”, ka thënë Ademi. Ndërsa përzgjedhësi Franco Foda ka theksuar se Austria është favorite e grupit, por Kosova do të synojë maksimalisht të garojë për pozitën e dytë dhe ta ruajë statusin në Ligën B. “Është e qartë se Austria është favorite, por është një grup interesant. Qëllimi ynë është të bëjmë gjithçka për ta arritur vendin e dytë, sepse është një grup i fortë. Të paktën duhet ta ruajmë nivelin dhe të mos biem

në Ligën C”, ka deklaruar Foda. Ai ka folur edhe për rikthimin në Austri, duke theksuar emocionin për t’u përballur me ish-ekipin dhe shpresën për mbështetje të madhe nga tifozët shqiptarë. “Sa i përket rikthimit në Austri, jam i lumtur të luaj kundër, t’i shoh ish-lojtarët e mi dhe shpresoj të kemi shumë mbështetje në Austri, por përqendrimi im është ende te muaji mars”, përfundoi përzgjedhësi i Kosovës. Kosova do ta nisë aventurën në Ligën B me synimin për të vazhduar me lojëra dhe rezultate pozitive dhe për të dëshmuar se i përket këtij niveli të garës në Ligën e Kombeve të UEFA-s.

UEFA publikon orarin e ndeshjeve të Kosovës në Ligën e Kombeve

UEFA ka publikuar orarin zyrtar të ndeshjeve për edicionin e ri të Ligës së

Kombeve, ku Kosova tashmë ka mësuar kalendarin e plotë të përballjeve në grup. “Dardanët” do ta nisin fushatën më 24 shtator me një ndeshje në shtëpi ndaj Republikës së Irlandës, në një përballje që pritet të jetë vendimtare për tonin e fillimit të garës. Vetëm tri ditë më vonë, më 27 shtator, Kosova do të udhëtojë për t’u përballur me Austrinë. Muaji tetor sjell dy sfida të tjera të rëndësishme. Më 1 tetor zhvillohet takimi Izrael - Kosovë, ndërsa më 4 tetor të besuarit e Franco Fodës rikthehen në shtëpi për përballjen Kosovë - Austri. Dy ndeshjet e fundit të fazës në grupe do të luhen në muajin nëntor. Më 14 nëntor Kosova pret Izraelin, ndërsa më 17 nëntor e mbyll ciklin me transfertën ndaj Irlandës. Me një kalendar të ngjeshur dhe përballje sfiduese brenda pak javësh, kombëtarja e Kosovës do të synojë paraqitje sa më pozitive për t’i arritur objektivat në këtë edicion të Ligës së Kombeve.



Finalja e Kupës së Kosovës në basketboll luhet më 18 shkurt në Rahovec

Prishtinë, 13 shkurt - Palestra “Mizahir Isma” në Rahovec do të jetë arena ku do të përballen Trepça dhe Bashkimi në finalen e këtij sezoni në kuadër të Kupës së Kosovës në basketboll.

Ndeshja finale do të zhvillohet javën e ardhshme, saktësisht më 18 shkurt dhe pritet një përballje e fortë pasi dy skuadrat synojnë këtë trofe. Trepça dhe Bashkimi ishin përballur edhe në finalen e

sezonit të shkuar, të cilën e kishte fituar ekipi nga Mitrovica me shifrat 85:79. Përderisa Trepça paraqitet për herën e pestë rresht në finalen e kësaj gare dhe synon ta mbrojë

trofeun e fituar sezonin e shkuar, Bashkimi luan për herën e dytë radhazi në ndeshjen finale dhe kërkon trofeun e dytë të Kupës në histori të klubit.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Shbaka Company” SH.P.K. Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812308030 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Shbaka Company” D.O.O. Prizren donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812308030 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Shbaka Company” L.L.C. Prizren has come to the decision to quit its business: 812308030 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Pizzeria Restaurant Familjar LUMI” SH.P.K. me seli në Glllogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812090710 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Pizzeria Restaurant Familjar LUMI” D.O.O. Glllogoc donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812090710 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Pizzeria Restaurant Familjar LUMI” L.L.C. with headquarters Glllogoc, has come to the decision to quit its business: 812090710 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Metis Studio” SH.P.K. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811315474.
- Denis Çoçaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Zenun Çoçaj”.
- Violeta Hoda shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” në Gjakovë.
- Andi Reznici shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Gasper Doci shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Osman Gjigja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Shaban Golaj” Lipovec Gjakovë.
- Miriman Krasniqi shpall te pavlefshme 2 dëftesat shme “ Ymer Prizreni” Prizren.
- Arifqe Gutaj shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u të gjimnazit “Gjon Buzuku” Prizren.
- Blerta Leku shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Nerxhivane Shabani shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë të Gjimnazit “Frang Bardhi”.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Florian Gllareva shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Dëshmoret e Fortesës” Verboc Drenas.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Enis Çoçaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Zenun Çoçaj”.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër:186/1
Datë: 13.02.2026

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 dhe 34 të Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës se Kosovës nr. 7/26 Mars),në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës së shkollës Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maurantëve të Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, në Republikën e Shqipërisë.

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.

Agjensioni turistik duhet t’i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjensioni duhet të ketë një para kontrate për rezervimin e hotelit në Durrës me data të caktuara sipas vendimit nga KDSH-ja **(prej 02 deri 06 Prill 2026).**
- Agjencioni turistik duhet t’i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës.
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të posedojë referencat nga organizimet e llojit të njëjtë në të kaluarën.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuara!

Kushtet tjera:

- ***Nisja duhet të bëhet më dt. 02.04.2026 dhe kthimi më dt. 06.04.2026***
- *Hoteli të posedojë sallë për ballo*
- *Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike*
- *Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner).*
- *Mundësi vizite në qytetet: Krujë, Tiranë, Durrësi i vjetër,Berat, Vlorë.*

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e Agjencinë AAAPARr-së në Prishtinë. Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi i ofertës
- Lloji i Hotelit (kategoria, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Gjendja teknike e autobusëve dhe numri
- Numri i referencave

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfituesit do të shpallet pasdite në tabelën e shpalljeve në AAAPARr në të njëjtën ditë.

Ofertuesit e interesuar ofertat e kompletuara me dokumentacionin e kërkuara ti dorëzojnë në Agjencinë e AAAPARr-së në Prishtinë rruga “Agim Ramanadani” ndërtesa MASHt II kati i tretë, gjatë orarit 08:00-14:00.

Hapjen e ofertave e bënë Komisioni sipas Udhëzimit Administrativ nr.02/2016.

Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë Agjencionet turistike që e kanë të kompletuar ofertën dhe që i plotëson kriteret e caktuara nga KDSH-ja.

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesionale dhe Arsimit për të Rritur mban të drejtën për anulimin e ofertës.

Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës pas orës 14:00.

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë) , ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Vërejtje: Secili ofertues duhet të aplikojë vetëm me një ofertë.

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore, hapja dhe vlerësimi i ofertave bëhet po atë ditë në zyrën Qendrore të Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesionale dhe Arsimit për të Rritur.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Vranina” Sh.p.k., Gllavaçicë, Komuna Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për zgjerimin e zonës së eksploatimit të inerteve në lokalitetin Gllaviçicë, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.04.2026 në ora 11:00 në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “Zef Serembe”, fshati Gllaviçicë, Komuna Pejë, do të organizohet debat publik nga Kompania “Vranina” Sh.p.k., Gllavaçicë, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyIMPR68piZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Vranina” Sh.p.k., Gllavaçicë, Pejë, për Pëlqim Mjedisor për zgjerimin e zonës së eksploatimit të inerteve në lokalitetin Gllaviçicë, Pejë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

<vnm.komente@rks-gov.net>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L